

Termet e Referencës (ToR)

Trajner në Fushën e Orientimit në Karrierë

1. Përshkrimi i Punës:

Në kuadër të projektit "Fuqizimi i Punesueshmërisë tek të Rinjtë dhe Grupet e Cenuara në Komunën e Ferizajt - YEOP II", organizata Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një trajner për orientimin në karrierë. Trajneri do të zhvillojë një program 3-ditor trajtimi për të rinjtë e marginalizuar, duke ofruar teknika dhe strategji për procesin e orientimit në karrierë, eksplorimin e karrierës, strategji hulumtuese të punës dhe karrierës.

2. Rreth Projektit:

Projekti "Fuqizimi i Punesueshmërisë tek të Rinjtë dhe Grupet e Cenuara në Komunën e Ferizajt - YEOP II" mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe SOS-Kinderdörfer Èeltëeit, Hermann-Gmeiner-Fonds Deutschland (HGFD). Ky program trevjeçar realizohet nga organizata "Syri i Vizionit" dhe fokusohet në përfundimin e mbështetjes për të rinjtë e marginalizuar dhe përgatitjen e tyre për hyrjen në tregun e punës. Qëllimi është të ofrojë mundësi dhe aftësi për të rinjtë që kanë hasur vështirësi në përfshirjen sociale dhe ekonomike, duke i ndihmuar ata të bëhen pjesë aktive në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

3. Qëllimi i Projektit:

Të ofrojë mbështetje dhe trajnim për të rinjtë e marginalizuar në komunën e Ferizajt, duke i përgatitur ata për hyrjen në tregun e punës dhe fuqizimin e tyre për të kontribuar aktivisht në shoqëri.

4. Objektivi i Trajnimit:

Trajnimi do të zhvillohet për një periudhë 3-ditore dhe do të përfshijë:

- Teknikat e orientimit në karrierë.
- Eksplorimin e karrierës
- Strategjitë hulumtuese të punës dhe karrierës dhe për zhvillimin e aftësive personale
- Aftësitë e transferueshme dhe të adaptueshme

5. Grupi i Synuar:

Të rinjtë e marginalizuar te cilet kane perfunduar trajnimin në modulet "Shkathtësitë bazë

jetësore” dhe “ Punësueshmërisë” në komunën e Ferizajt, të cilët kanë hasur vështirësi në përfshirjen sociale dhe ekonomike.

6. Metodologjia:

Trajnimi do të realizohet përmes:

- Diskutimeve interaktive për të theksuar rëndësinë e orientimit në karrierë.
- Aktivitete praktike për zhvillimin e aftësive në eksplorimin e karrierës.
- Aktivitete praktike për zhvillimin e strategjive hulumtuese të punës dhe karrierës dhe zhvillimit të aftësive personale.
- Aktivitete grupore për të përvetësuar aftësitë e transferueshme dhe të adaptueshme

7. Periudha e Angazhimi:

- Përgatitja e materialeve për zhvillimin e trajnimit – 2 Ditë
- Zhvillimi I trajnimit – 3 Ditë
- Raportimi – 2 Ditë

8. Cilësitë e Kërkuara nga Trajneri:

Trajneri duhet të ketë:

- Ekspertizë në orientimin në karrierë dhe zhvillimin e aftësive të kërkimit të punës.
- Përvojë në punën me të rinjtë, veçanërisht me ata që janë të marginalizuar.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi, me një qasje inkurajuese.
- Kreativitet dhe fleksibilitet në dizajnimin e aktiviteteve trajnimit që janë interaktive dhe përfshirëse.
- Kapacitet për të punuar në grup dhe për të krijuar një ambient mbështetës dhe motivues.

9. Dokumentet dhe Informacionet e Kërkuara nga Trajneri:

1. **CV:** Një dokument i detajuar që përmban informacione për përvojën profesionale, arsimimin dhe aftësitë relevante.
2. **Letër Motivimi:** Një letër që shpreh interesin për pozitën dhe përshkruan përvojën e mëparshme në trajnim dhe orientim në karrierë.
3. **Dëshmi të Kualifikimeve:** Kopje të diplomave, certifikatave ose trajnimeve që lidhen me orientimin në karrierë dhe zhvillimin e aftësive personale.
4. **Plan Trajnimi:** Një draft ose përmbledhje të metodologjisë dhe planin e trajnimit
5. **Përvojë e Dëshmuar:** Informacione për projekte të ngjashme të realizuara më parë, duke përfshirë rezultatet dhe impaktin e tyre.
6. **Oferta financiare**



Syri i Vizionit



10. Kushtet e Pagesës:

Pagesa e trajnerit do të bëhet sipas kontratës përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën euro. Në përputhje me ligjin e Kosovës, Syri i Vizionit është i obliguar të paguajë tatimin (taksa dhe pension) prej 10% të shumës bruto. Pagesa finale do të bëhet pas përfundimit me sukses të trajnimit, siç është përcaktuar në ToR.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në adresën e e-mailit:

office@syriivizionit.org me titull: "Aplikimi për Trajner në Orientim në Karrierë".

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është:

01 nëntor 2024, ora 16:00.

Vetëm kandidatët e sukseshëm do të kontaktohen!